

MBI
AUDITIMIN E USHTRUARNË
DREJTORINË RAJONALE TË AGJENCISË SË LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT
DHE INTEGRIMIT TË ZONAVE/NDËRTIMEVE INFORMALE, BERAT

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Drejtorinë Rajonale të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Berat**, me objekt: *“Mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për legalizimin e ndërtimeve informale”*, lloji i auditimit: *“Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”*, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri 31.12.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 128, datë 22.09.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 *“Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”*, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 538/10, datë 22.09.2014, i ka rekomanduar z. Përparim Sino, Drejtor i ALUIZNI Berat, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetjet nga auditimi: Nuk është bërë inventarizimi i dosjeve të personave që ka paraqitur kërkesë për legalizim, dosje të cila duhet të përmbajë; vetedeklarimin, 4 copë foto, certifikaten personale dhe familjare, gentplanin, verifikimet reale të ndërtimeve, hartat hartografike të planvendosjes në terren të ndërtimeve pa leje dhe territoreve të zëna, kufijtë dhe shtrirjen sipërfaqësore të vendbanimit formal, të zonës informale (miratuar nga KRRTRSH-ja) etj, duke ia dorëzuar atë zyrës përkatëse të ALUIZNI-t për shqyrtim për leje legalizimi, veprime në kundërshtim me neni 6 pikat a,b,c dhe d, nenin 7 pika 1 dhe 2, neni 17 pika 3, si dhe neni 27 pika a, b dhe f, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, me ndryshime.

1.1 Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Berat, të nxjerrë urdhër të brendshëm për kryerjen e inventarizimit fizik dosjeve, dhe kalimi i dosjeve nga sektori në sektor të bëhet me procesverbal të administruar me numër protokolli dhe inventar, detyrë e cila duhet pasur parasysh vazhdimisht.

Menjëherë

2. Gjetjet nga auditimi: Gjatë legalizimit të ndërtimeve informale nga ALUIZNI Berat nuk janë respektuar dispozitat e nenit 39, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 *“Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”*, i ndryshuar, pika 2, e VKM nr. 438, datë 28.06.2006 *“Për përcaktimin e kriterëve, te procedurave dhe te dokumentacionit te zbatueshëm, për te kualifikuar objektet ne ndërtim qe legalizohen ose jo”*, pasi ndërtimet informate të legalizuara bien ndesh me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Berat, miratuar me Vendim të KKT-së nr. 7, datë 20.12.2012, e Rregulloren në zbatim të tij.

2.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Berat, mbështetur në dokumentacionin që disponohet dhe korrespondencës me Bashkinë Berat, të bëjë azhurnimin e Studimit të Planit të Përgjithshëm Vendor (miratuar me vendim të KKT-së nr. 7, datë 20.12.2012), në zbatim të procesit të legalizimit të ndërtimeve informale.

Brenda datës 31/12/2014

3. Gjetjet nga auditimi: Mungesa e Rregullores së Brendshme për funksionimin e sektorëve të Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Berat, në përputhje me Rregulloren e

Brendshme të Drejtorisë Qendrore të ALUIZNI-t dhe ligjit nr. nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

3.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Berat, të rishikoj rregulloren e brendshme për funksionimin e institucionit duke ndarë detyrat për çdo sektor dhe punonjës.
Menjëherë

4. Gjetjet nga auditimi: Legalizimi i ndërtimeve informale nuk është në përputhje me nenin 2, pika 4 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, VKM Nr. 438, datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim që legalizohen ose jo”, pika 2/b, pasi objektet informale të legalizuara prekin strukturës e rrugës ose janë në një distancë nën 5 m nga bordura e rrugës.

4.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Berat të marrë masa që lejet e legalizimit të lëshohen në respektim të ligjit dhe kriterëve të përcaktuara.

Në vijimësi

5. Gjetjet nga auditimi: Nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNIT Berat nuk është bërë i mundur derdhja në Buxhetin e Shtetit të detyrimeve për tatimin mbi të ardhurat dhe kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësorë të llogaritur dhe mbajtur për çdo punonjës, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9766, datë 09.07.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 9766, datë 10.7.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, si dhe për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të ndaluar nga pagat e punëmarrësve është shkelje e nenit 13, “Detyrimi për të paguar kontributet” të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore”, i ndryshuar, pika 3, dhe nenit 18, si dhe neni 13, i ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”.

5.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Berat, të marrë masa dhe të kryej pagesën e detyrueshme në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Berat, për detyrimet e llogaritur e ndaluar nga paga punonjësve për tatimin mbi të ardhurat dhe kontributin e sigurimet shoqërore e shëndetësore me vlerë **4,351,101 lekë**, nga e cila; tatim mbi të ardhurat 707,010 lekë dhe kontributi i sigurimeve shoqërore e shëndetësore në vlerën 3,644,091 lekë.

Brenda datës 31/12/2014

6. Gjetjet nga auditimi: Konstatohet se dokumentacioni ligjorë i cili vërteton se objekti informal është në pronë private nuk është original por fotokopje e cila nuk rezulton të jetë e noterizuar, veprime të cilat nenin 39 germa f, nenet 40, 54, 56, të ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar dhe pikat 3, 4, 7, të Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005, të ndryshuar.

6.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Berat të marrë masa që dokumentacioni ligjor i cili vërteton se objekti informal është në pronë private të jetë original ose fotokopje e noterizuar, sipas kërkesave ligjore.

Në vijimësi

7. Gjetjet nga auditimi: Dosjet e personelit të punonjësve të Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Berat janë të pa inventarizuara, siç përcaktojnë kriteret e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nenit 56, të ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar, e pikat 3, 4, 7, të Udhëzimit të MD nr. 6291, datë 17.08.2005, të ndryshuar.

7.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Berat të marrë masa për inventarizimin e dosjeve të personelit dhe plotësimin me dokumentacion original ose

fotokopje të noterizuar (diplomat dhe listën e notave), duke bërë ristruktimin e klasifikimit të pagave sipas dispozitave ligjore.

Menjëherë

8. Gjetjet nga auditimi: Në prokurimin e blerjeve me vlera të vogla janë konstatuar shkelje të nenit 12, pika 2, të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe pikat 1/c dhe 2/c, Kreu VI, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, pasi procesverbali i vlerësimit të ofertave është nënshkruar vetëm nga kryetari i komisionit të blerjeve dhe nga asnjë anëtarë tjetër.

8.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Berat të marrë masa për zbatimin e saktë “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, sipas dispozitave ligjore.

Menjëherë

9. Gjetjet nga auditimi: Nuk është bërë i mundur nxjerrja jashtë përdorimit e materialeve dhe mallrave me vlerë 273,119 lekë, të evidentuara si të tilla nga ana e komisionit për vitin 2013, por janë mbajtur gjendje në magazinë, duke mos ndjekur procedurat e 104, 106, 108 e 109, të udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik”.

9.1 Rekomandimi: Nga Zyra e Financës së ALUIZNI-t Berat të merren masat që materialet e inventarit të imët dhe mallrave, të përcaktuara si jashtë përdorimit dhe që janë gjendje në magazinë, të zbatohet procedura ligjore për nxjerrjen jashtë përdorimit.

Menjëherë

10. Gjetjet nga auditimi: Konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Berat lejet e legalizimit nuk janë lëshuar në përputhje me nenin 28, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje“, i ndryshuar, pasi në 16 raste këto leje varjen nga 4 muaj deri në 3 vjet, duke mos paraqitur asnjë dokumentacion ligjorë mbi shkeljen e këtij afati.

10.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Berat të marrë masa që lejet e legalizimit të lëshohen brenda afateve të përcaktuara.

Në vijimësi

11. Gjetjet nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Berat në në klasifikimin e 222 ndërtimeve informale i ka klasifikuar si të parregullta, pasi nuk plotësojnë kriteret e pikës 5 të nenit 2 dhe nenit 33, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje“, i ndryshuar dhe nga kjo administratë nuk është procedura më tej në ç’kualifikimin e tyre, sipas pasqyrës Aneksi 1 (bashkangjitur Raport Përfundimtar të Auditimit).

11.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Berat të marrë masa për evidentimin e 222 ndërtimeve informale të cilat nuk plotësojnë kriteret e ligjit të legalizimit, si dhe të ndiqen procedurat për ç’kualifikimin e tyre, deri në hartimin e listave për INUV/INUK.

Brenda datës 30/12/2014

12. Gjetjet nga auditimi: Gjatë procesit të legalizimit të ndërtimeve informale dhe parcelave ndërtimore mbi të cilat janë ndërtuar këto objekte, janë lënë jashtë procesit të legalizimit pjesë të sipërfaqes së parcelës ndërtimore, sipërfaqe të cilat janë në zotërim nga poseduesi i ndërtimit informal në fakt, pasi është e pamundur të konfigurohen në parcela të veçanta ndërtimore, veprime në kundërshtim me neni 3, germa “F” dhe nenin 17 pika 1, e ligjit nr. 9482 datë 3.4.2006 “Për Legalizimin Urbanizimin dhe Integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

12.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Berat të marrë masa dhe të ndjekë procedurat administrative, duke iniciuar me poseduesit për korrigjimin e kontratave të shitjes së truallit të ndërtimeve informale, në 77 praktika për sipërfaqen 33191.64 m².

arkëtuar më pak në vlerë 85,776,611 mijë lekë, nga e cila; me bono privatizimi prej 38,183,003 lekë dhe me lek prej 38,392,706 lekë, si diferencë e pagesës së sipërfaqes së parcelës ndërtimore të paguar, me sipërfaqen e vëtedeklaruar dhe që zotëron poseduesi i ndërtimit informal në fakt (këto sipërfaqe në asnjë rast nuk mund të parcelizohen), duke bashkëpunuar me NjQV dhe ZVRPP-në.

Brenda datë 31/12/2014

13. Gjetjet nga auditimi: Gjatë procesit të legalizimit të ndërtimeve informale është konstatuar se legalizimi i tyre është bërë në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 438, datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, si dhe të neneve 31, 32 e 33, të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, VKM nr. 6, datë 07.01.2005 “Për miratimin e zonave arkeologjike, brenda qendrave të banuara në Shkodër, Lezhë, Krujë, Durrës, Elbasan, Berat, Vlorë dhe Sarandë”, Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Berat, miratuar me Vendim të KKT-së nr. 7, datë 20.12.2012, e Rregulloren në zbatim të tij, VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e modelit të rregullores “për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të Ujësjetllës-Kanalizimeve SH.A”, rregullore për furnizimin me ujë dhe kanalizimet në zonën e shërbimit të UK, pjesa e dytë sistemet e furnizimit me ujë, pika 5, pasi këto objekte informale gjatë procesit të legalizimit cenojnë dispozitat e akteve ligjore si mësipërm, duke u legalizuar në zonë tampon të qytetit të beratit, sipër kolektorëve të ujësjetllësit ose pranë kanale kullues, prekin studimet urbanistike etj.

13.1 Rekomandimi: T’i kërkohet Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, që për objektet informale të pajisura me leje legalizimi dhe për ato që kanë lidhur kontratat, të fillojë procedurat, për rishikimin dhe shfuqizimin e lejeve të legalizimit të dhëna në kundërshtim me dispozitat ligjore e nënligjore, për sa poshtë vijon:

-**Në 3 (tre) praktika**, legalizimi i ndërtimeve informale nuk është në përputhje ligjin për integritetin e Monumenteve të Kulturës e zonave arkeologjike, brenda qendrave të banuara në Shkodër, Lezhë, Krujë, Durrës, Elbasan, Berat, Vlorë dhe Sarandë”.

- **Në 41 (dyzetenjë) praktika**, legalizimi i ndërtimeve informale nuk është në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Berat, pasi ndërtimet informate të legalizuara bien ndesh me këto studime.

-**Në 36 (tridhjetegjashhtë) praktika**, legalizimi i ndërtimeve informale nuk janë zbatuar procedurat ligjore, pasi objektet informate të legalizuara prekin strukturës e rrugës.

- **Në 5 (pesë) praktika**, legalizimi i ndërtimeve informale janë kryer në kundërshtim me ligjet në zonën e shërbimit të Ujësjetllës-Kanalizimeve SH.A”.

- **Në 2(dy) praktika**, legalizimi i ndërtimeve informale është bërë pa objekt ndërtimi (në momentin e legalizimit), të zbatohet procedura ligjore “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objekte në ndërtim, që legalizohen ose jo”.

Brenda datë 31/12/2014

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Të merren masa dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **18,071,132 lekë**, nga **38 persona**, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, si më poshtë:

1. Gjetjet nga auditimi: Nga zyra e financës në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Berat, kryerja e pagesës për punonjësit me kontratë është bërë në kundërshtim me klasën e IX, lidhja II/1, të VKM nr. 551, datë 11.08.2011.

1.1 Rekomandimi: Në vlerën **233,353 lekë** në ngarkim të **2 (dy) punonjësve**, përkatësisht;
- Vlera **160,069 lekë** në ngarkim të punonjësit **A.P.**;
- Vlera **73,284 lekë** në ngarkim të punonjësës **S.Q.**;

Brenda datë 31/12/2014

2. Gjetjet nga auditimi: Nga zyra e financës në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Berat, janë kryer pagesa për karta telefoni në kundërshtim me VKM nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me telefoninë celulare të personave juridik dhe publik”.

2.1 Rekomandimi: Për vlerën **39,000 lekë**, në ngarkim të punonjësit **K.P.**, me detyrë ish-drejtor i ALUIZNI për vitin 2012, për përballim të shpenzimeve të telefonisë celulare.

Brenda datë 31/12/2014

3. Gjetjet nga auditimi: Në kundërshtim me pikën 5 të nenit 2, i ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimet.” I ndryshuar, është bërë rimbursimi i poseduesit të ndërtimit informal, si një ndërtim i parregullt, por që në dosjen e tij mungonte dokumentacioni ligjorë mbi argumentimin se objektit është i ç’kualifikuar.

3.1 Rekomandimi:

Vlera **414,160 lekë**, në ngarkim të 2 punonjësve:

- **Z. K.P.** në cilësinë e ish-drejtorit, për vlerën **207,080 lekë**.

- **Z. A.M.** në cilësinë e ish-p/sek.lagalizim/urbanizim, për vlerën **207,080 lekë**.

Për dëmin ekonomik të shkaktuar nga rimbursimi i vlerës prej **414,160 lekë**, të poseduesit “E.Ç.”.

Brenda datë 31/12/2014

4. Gjetjet nga auditimi: Gjatë procesit të legalizimit të ndërtimeve informale nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Berat është bërë ndryshimi i funksionit të objektit informal, duke bërë që të ndryshojnë vlerat për tarifën e parcelës ndërtimore të legalizuar, veprim në kundërshtim me nenin 6,7,9 dh 10, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, VKM nr. 437, datë 28.06.2006 “Për procedurat e mbledhjes, përpunimit dhe administrimit të të dhënave për ndërtimet pa leje për ngritjen e bazës së të dhënave”, pika 1, germa “i”, pika 2 dhe pika 3, pika 8, pika 1, germa “a” e udhëzimit nr. 6, datë 08.11.2006 “Dokumentacionin tekniko-ligjor për miratimin e kufirit të zonës/vendbanimit/bllokbanimit/ndërtimit informal të veçuar dhe të territoreve të tjera me ndërtime pa leje”, pika 3 e udhëzimit nr. 7, datë 08.11.2006 “Mënyrën e plotësimit dhe ruajtjen e të dhënave për ndërtimet pa leje”.

4.1 Rekomandimi: Në 4 (katër) raste për vlef tën **1,341,383 lekë**, për legalizim të objekteve informate me funksion të ndryshëm nga ai i vetëdeklaruar.

Brenda datë 31/12/2014

5. Gjetjet nga auditimi: Gjatë procesit të legalizimit të ndërtimeve informale është konstatuar se sipërfaqja e legalizuar nuk përputhet me sipërfaqen e vetëdeklaruar dhe të konstatuar në terren nga specialistët e terrenit, e cila është e evidentuar si në hartën fushore (genplan) po ashtu dhe në procesverbalet e konstatimit, duke bërë që sipërfaqja e legalizuar të jetë më e vogël se sa ajo që poseduesi ka në zotërim dhe të konstatuar nga grupet e terrenit, veprime në nenin 17 dhe nenit 20, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

5.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Berat, të merren masa dhe të ndiqen të gjitha procedurat administrative, duke iniciuar me individët për korrigjimin e kontratave të shitjes së truallit të personave të ndërtimeve informale, për **28 praktika** me

sipërfaqe 4712.72 m², arkëtuar më pak vlera prej **15,809,883 lekë**, nga e cila; pagesë me bono prej 7,345,884 lekë dhe pagesë në lekë prej 8,463,999 lekë, si diferencë e pagesës së sipërfaqes së parcelës ndërtimore, me sipërfaqen e vetëdeklaruar dhe të evidentuar në procesverbal konstatimi dhe genplanin e hartës fushore, të cilën zotëron në fakt poseduesi, duke i shkaktuar një dëm buxhetit të shtetit për fondin e kompensimit të ish-pronarëve dhe cenim të interesit publik”.

Brenda datë 31/12/2014

6. Për të gjithë emrat e evidentuara nga pika 5 dhe 6, të njoftohet ZVRPP dhe ZQRPP që të marrë masa për vendosjen e barrës (shënim hipotekor), deri në shlyerjen e detyrimit për tu nxjerrë.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 37 dhe 144, të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenit 12 të kontratës individuale të punës, t’i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t, që të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore:

C/1. “Vërejtje”, germa ” a”.

1. Znj. V.B. me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Financës, për:

- Mos zbatim të procedurave për blerjeve me vlerë të vogël për periudhën e vitit 2012, veprime në kundërshtim me neni 12, pika 2, të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe pika 1/c dhe 2/c, Kreu VI, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar.
- Mos zbatim të kërkesave të VKM nr. 551, datë 11.08.2011, klasa IX, lidhje II/1, për pagesat e kryera ndajë 3 (tre) punonjësve me kontratë.

C/2. “ Zgjidhjen e kontratës së punës”, pika “d”, për:

1. Znj. D.Ç. me detyrë Specialiste e Sektorit të Hartografisë.

Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore të ligjit të legalizimeve, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale dhe përgatitjen e dokumentacionit për kualifikimin dhe certifikimin të objektit informal (leje legalizimi), si;

-në 1 (një) rast për vleftën 893,000 lekë, si dëm ekonomik në buxhetin e shtetit në fondit e kompensimit të ish-pronarëve, për legalizimin e objektit informal me funksion të ndryshëm nga ai i vetëdeklaruar, veprime në kundërshtim me nenin 6,7,9 dh 10, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, VKM nr. 437, datë 28.06.2006 “Për procedurat e mbledhjes, përpunimit dhe administrimit të të dhënave për ndërtimet pa leje për ngritjen e bazës së të dhënave”, pika 1, germa “i”, pika 2 dhe pika 3, pika 8, pika 1, germa “a” e udhëzimit nr. 6, datë 08.11.2006 “Dokumentacionin tekniko-ligjor për miratimin e kufirit të zonës / vendbanimit / bllokbanimit / ndërtimit informal të veçuar dhe të territoreve të tjera me ndërtime pa leje”, pika 3 e udhëzimit nr. 7, datë 08.11.2006 “Mënyrën e plotësimit dhe ruajtjen e të dhënave

për ndërtimet pa leje”, si dhe pika 2.1, 3.1,3.2, 3.4 germa “ii” dhe 5.1 e urdhrit nr. 46, datë 18.07.2006 për “Miratimin e manualit të hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike”.

-në 55 (pesëdhjetepesë) raste, gjatë procesit të legalizimit të ndërtimeve informale dhe parcelave ndërtimore mbi të cilat janë ndërtuar këto objekte, janë lënë jashtë procesit të legalizimit pjesë të sipërfaqes së parcelës ndërtimore, sipërfaqe të cilat janë në zotërim nga poseduesi i ndërtimit informal në fakt, pasi është e pamundur të konfigurohen në parcela të veçanta ndërtimore, duke mos llogaritur vlerën e parcelës ndërtimore **prej 54,912,165 lekë**, si një e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit në fondin e kompensimit të ish-pronarëve, veprime në kundërshtim me neni 3, germa “f” dhe nenin 17 pika 1, e ligjit nr. 9482 datë 3.4.2006, i ndryshuar.

-në 13 (trembëdhjetë) raste, legalizimi i ndërtimeve informale nuk është në përputhje me nenin 2 dhe neni 39, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, i ndryshuar, pika 2, e VKM Nr. 438, datë 28.06.2006, VKM nr. 259, datë 04.05.2007, VKM nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit dhe zhvillimit të territorit”, studimet pjesore urbanistike të lagjes; “Çlirimi, Dëshmorët e Kombit dhe Barrikadë”, si dhe Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Berat, miratuar me Vendim të KKT-së nr. 7, datë 20.12.2012, e Rregulloren në zbatim të tij, pasi ndërtimet informate të legalizuara bien ndesh me këto studimet urbanistike.

-në 1 (një) rast, legalizimi i ndërtimit informal është bërë pa objekt ndërtimi (në momentin e legalizimit), veprime në kundërshtim me nenin 1 dhe 2, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, si dhe pika 1, e VKM nr. 438, datë 28.06.2006.

2. Znj. A.G. me detyrë ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizim/Urbanizimit;

Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore të ligjit të legalizimeve, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale dhe përgatitjen e dokumentacionit për kualifikimin dhe certifikimin të objektit informal (leje legalizimi), si;

-në 1 (një) rast për vleftën 893,000 lekë, si dëm ekonomik në buxhetin e shtetit në fondit e kompensimit të ish-pronarëve, për legalizimin e objektit informal me funksion të ndryshëm nga ai i vetëdeklaruar, veprime në kundërshtim me nenin 6,7,9 dh 10, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, i ndryshuar, VKM nr. 437, datë 28.06.2006, pika 1, germa “i”, pika 2 dhe pika 3, pika 8, pika 1, germa “a” e udhëzimit nr. 6, datë 08.11.2006 “Dokumentacionin tekniko-ligjor për miratimin e kufirit të zonës / vendbanimit / bllokbanimit / ndërtimit informal të veçuar dhe të territoreve të tjera me ndërtime pa leje”, pika 3 e udhëzimit nr. 7, datë 08.11.2006 “Mënyrën e plotësimit dhe ruajtjen e të dhënave për ndërtimet pa leje”, si dhe pika 2.1, 3.1,3.2, 3.4 germa “ii” dhe 5.1 e urdhrit nr. 46, datë 18.07.2006 për “Miratimin e manualit të hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike”.

-në 53 (pesëdhjetetre) raste, gjatë procesit të legalizimit të ndërtimeve informale dhe parcelave ndërtimore mbi të cilat janë ndërtuar këto objekte, janë lënë jashtë procesit të legalizimit pjesë të sipërfaqes së parcelës ndërtimore, sipërfaqe të cilat janë në zotërim nga poseduesi i ndërtimit informal në fakt, pasi është e pamundur të konfigurohen në parcela të veçanta ndërtimore, duke mos llogaritur vlerën e parcelës ndërtimore **prej 47,002,044 lekë**, si një e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit në fondin e kompensimit të ish-pronarëve, veprime në kundërshtim me neni 3, germa “f” dhe nenin 17 pika 1, e ligjit nr. 9482 datë 3.4.2006, i ndryshuar.

-në 3 (tre) raste, legalizimi i ndërtimeve informale nuk është në përputhje me nenin 2 dhe neni 39, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, pika 2, e VKM nr. 438, datë 28.06.2006, VKM nr. 259, datë 04.05.2007, VKM nr. 502, datë 13.07.2011, si dhe Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Berat, miratuar me Vendim të KKT-së nr. 7, datë 20.12.2012, e Rregulloren në

zbatim të tij, pasi ndërtimet informate të legalizuara bien ndesh me këto studimet urbanistike.

-në 1 (një) rast, legalizimi i ndërtimit informal është bërë pa objekt ndërtimi (në momentin e legalizimit), veprime në kundërshtim me nenin 1 dhe 2, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, si dhe pika 1, e VKM nr. 438, datë 28.06.2006.

-në 1 (një) rast, legalizimi i ndërtimit informal nuk është në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, VKM nr. 438, datë 28.06.2006, pika “ç”, ku thuhet: “cenon integritetin e Monumenteve të Kulturës, sipas përcaktimit të pikës 1, të nenit 29, të ligjit nr. 9048 datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të specifikuar nga materiali i botuar i Institutit të Monumenteve të Kulturës, sipas përcaktimit të nenit 38, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006”, pika “iii”, ku thuhet: “zonë me vlera arkeologjike, muzeale e historike ose në kufi me objektet apo strukturat ndërtimore me vlera të veçanta, sipas përcaktimit të neneve 73 e 74, të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar, të neneve 31, 32 e 33, të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, si dhe VKM nr. 6, datë 07.01.2005 “Për miratimin e zonave arkeologjike, brenda qendrave të banuara në Shkodër, Lezhë, Krujë, Durrës, Elbasan, Berat, Vlorë dhe Sarandë”.

-në 4 (katër) raste, legalizimi i ndërtimeve informale nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 2, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, i ndryshuar, VKM Nr. 438, datë 28.06.2006, pika 2/b, VKM nr. 259, datë 04.05.2007, nenin 40, të VKM nr. 502, datë 13.07.2011, si dhe Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Berat, miratuar me vendim të KKT-së nr. 7, datë 20.12.2012 e Rregullores në zbatim të tij (skema e miratuar e rrjetit rrugorë), pasi objektet informate të legalizuara prekin strukturën e rrugës.

-në 4 (katër) raste, legalizimi i ndërtimeve informale është kryer në kundërshtim me ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, VKM nr. 438, datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo”, pika 2, germa “ dh ”, si dhe VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e modelit të rregullores “për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të Ujësjetës-Kanalizimeve SH.A”, rregullore për furnizimin me ujë dhe kanalizimet në zonën e shërbimit të UK, pjesa e dytë sistemet e furnizimit me ujë, pika 5, ku thuhet se; Ndalohej kategorikisht ndërtimi i objekteve mbi tubacionet e ujit të pijshëm.

-në 4 (katër) raste, gjatë procesit të legalizimit të ndërtimeve informale dhe parcelave mbi të cilat janë ndërtuar këto objekte, janë lënë jashtë procesit të legalizimit sipërfaqe parcelë ndërtimore të vetëdeklaruar dhe në zotërim nga poseduesi i ndërtimit informal, konfirmuar dhe nga të dhënat e procesverbal konstatimeve dhe hartës fushore (genplan) të specialistëve të terrenit, në të cilën evidentohet një vlerë prej **3,175,500 lekë**, si një e ardhur me dëm ekonomik në buxhetin e shtetit në fondin e kompensimit të ish-pronarëve, veprime të cilat bien ndesh me nenin 17 dhe nenit 20, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006.

C/3. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR NGA DETYRA DHE QË NUK KANË ADRESIM INSTITUCIONAL

a). Për 4 ish drejtues dhe specialistë nuk mund të rekomandohet masë disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur prej 6 muajsh nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre, megjithatë për ta të njoftohet Departamenti i Administratës Publike.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte “**zgjidhje e kontratës së punës**”, përkatësisht:

1. z. K.P. me detyrë ish-drejtor;
2. z. A.B. me detyrë ish-drejtor;
3. z.A.M. me detyrë ish-përgjegjës i sektorit të legalizim/urbanizimit;
4. z. R.B. me detyrë ish-specialist i sektorit të hartografisë;

Për këto arsye:

-Për moszbatim të kërkesave të ligjit të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, VKM nr. 438, date 28.06.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe te dokumentacionit te zbatueshëm, për te kualifikuar objektet në ndërtim që legalizohen ose jo”.

-Për të metat e mangësi të konstatuara, në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor në legalizimin e ndërtimeve informate, sipas trajtimit në procesverbale dhe në kapitujt përkatës të Raportit Përfundimtar të auditimit, të paraqitur në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Berat.

Për 4 ish drejtues e punonjësit e mësipërm, Drejtori i Drejtorisë Qendrore të ALUIZNI të njoftojë Departamentin e Administratës Publike për masat disiplinore me qëllim kryerjen e regjistrimeve të nevojshme në Regjistrin Qendror të Personelit.

b). Për 15 ish-specialistë e Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Berat të përmendur në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në varësi të shkeljeve të kryera në zbatim ligjit të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, VKM nr. 438, date 28.06.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe te dokumentacionit te zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim që legalizohen ose jo”, nga ana e jonë do të rekomandohej si masë disiplinore “vërejtje**”, përkatësisht:**

1. z. A.A. me detyrë ish-specialist i sektorit të hartografisë;
2. z. A.P. me detyrë ish-specialist terreni;
3. z. V.P. me detyrë ish-specialist terreni;
4. z. S.D. me detyrë ish-specialist terreni;
5. z. B.M. me detyrë ish-specialist terreni;
6. z. V.K. me detyrë ish-specialist terreni;
7. z. A.K. me detyrë ish-specialist terreni;
8. z. N.Sh. me detyrë ish-specialist terreni;
9. z. Gj.B. me detyrë ish-specialist terreni;
10. z. S.G. me detyrë ish-specialist llogaritjes tarifave;
11. z. V.M. me detyrë ish-specialist terreni;
12. z. B.G.me detyrë ish-specialist terreni;
13. z. Q.D. me detyrë ish-specialist terreni;
14. z. T.H. me detyrë ish-specialist terreni;
15. z. O.Z. me detyrë ish-specialist terreni;

D. KALLËZIM PENAL

Bazuar në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 281, me shkrësën nr. 538/11, datë 22.09.2014 kemi bërë kallëzim penal duke dërguar për veprime të mëtejshme procedurale në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Berat:

- 1. Z. K.P. me detyrë ish-Drejtor i ALUIZNI-t Berat**
- 2. Z. A.M. me detyrë ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizim/Urbanizimit**
- 3. Znj. D.Ç. me detyrë Specialiste e Sektorit të Hartografisë**

4. Znj. A.G. me detyrë ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizim/Urbanizimit

5. Z. R.B. me detyrë Specialiste e Sektorit të Hartografisë

Nga Drejtorinë Rajonale të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Berat, me shkresë nr. 708/1, prot, datë 14.10.2014, protokolluar në KLSH me nr.538/12 datë 16.10.2014, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar dhe zbatuar.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Hysen Mëtko, Kristaq Gjurgjaj dhe Aleksandër Papadhimitri më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT